



Arben Merkoçi aktualisht është profesor në ICREA dhe drejtor i Grupit të Nanobioelektronikës dhe Biosensorëve në Institutin Català de Nanociencia i Nanotecnologia (ICN2), pjesë e Institutit të Shkencës dhe Teknologjisë së Barcelonës (BIST). Pas mbrojtjes së doktoratës (1991) me temë Elektrodat Jon-selektive (ISEs) në Universitetin e Tiranës, Dr. Merkoci ka punuar si posdoktorantë dhe studiues i lartë/ Profesor i ftuar në fushën e nanobiosensorëve dhe teknologjisë “lab-on-a-chip” në Itali, Spanjë, ShBA, dhe nga 2006 është pjesë e ICN2. Prof. Merkoci është përqëndruar në punën e tij në modelimin dhe zbatimin e nanoteknologjisë më të përparuar të bazuar në

nanoshkencën e biosensorëve me kosto /efiçencë. Nanobiosensorët me bazë letre / plastike përfshijnë integrimi i molekulave biologjike (ADN-ja, antitruapat, qelizat dhe enzimat) dhe receptorë të tjerë (bio) me mikro- dhe nanostruktura / motorë dhe mund të aplikohen në diagnostikim, monitorim mjedisor ose në siguri. Ai ka publikuar rreth 280 hulumtime dhe vlersime për punën e kolegëve, mbikëqyrur rreth 27 studentë doctorate dhe është ftuar vqë të mbajë leksione apo edhe të shprehet mendimet në fjalime të ndryshme në rreth 150 raste në vende të ndryshme.

Prof. Merkoçi është redaktor i revistës Biosensors dhe Bioelectronics, revista kryesore ndërkombëtare e përkushtuar për hulumtimin, hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e biosensorëve dhe bioelektronikës, dhe gjithashtu anëtar i bordit editorial të revistave Elktoanalizë, Microchimica Acta, dhe shumë të tjera.

Ai është gjithashtu i përfshirë në mësimdhënien e kurseve të doktoratës në fushën e biosensorëve të bazuar në nanomateriale në disa Qendra spanjolle dhe ndërkombëtare, ka qenë anëtarë i komisionit për krijimin Programit të ri akademik universitar për nanoshkencën dhe nanoteknologjinë në UAB, ku për herë të parë e filloi këtë proces në vitin akademik 2010-2011 në Spanjë. Aktualisht vepron si koordinatori i modulit “Nano for Diagnostics”, moduli kryesor në UAB. Ai aktualisht është anëtar i Grupit Akademik të Punës të BIST. Prof. Merkoci ka mbikëqyrur 25 studentë doktorantë (kombëtarë dhe ndërkombëtarë), si dhe ka ndjekur disa student postdoktorantë dhe studius të ndryshëm në laboratorin e tij. Ai ka qenë anëtarë dhe në disa raste edhe kryetar i më shumë se 30 komisioneve për mbrojtjen e doktoraturës. Z. Merkoci ka përfituar disa grante kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zbatimin e nanomaterialeve në biosensorë dhe grupi i tij po bashkëpunon me disa udhëheqës në mbarë botën duke udhëhequr disa laboratorë në fushën e nanobiosensorëve. Prof. Merkoçi shërben gjithashtu si vlerësues shkencor dhe anëtar i paneleve të ndryshme ekspertësh të agjencive të ndryshme ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare (FP EU, USA, panele të ndryshme të BE-së dhe vendeve të tjera), anëtar i Komitetit Shkencor të Kongreseve të ndryshme ndërkombëtare, si dhe drejtues i disa ëorkshopeve dhe eventeve të tjera shkencore.

Ai është bashkëthemelues i dy ndërmarrjeve “spin-off”, “PaperDrop” kushtuar nanodiagnostikimit dhe “Graphenicalab” në printimin elektronik.